BASHKIA
MALIQ

RAPORTI I PERFORMANCËS 2026

TRANSPARENCË

PËRGJEGJSHMËRI

ZHVILLIM



PËRMBAJTJA

Fjalor Shpjegues 3

Qellimi I Raportit 7

Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë 8

SHERBIME PUBLIKE VENDORE 9

Arsimi Parauniversitar 10

Menaxhimi i Mbetjeve 13

Mbrojtja nga zjarri 15

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit 16

Administrimi i pyjeve dhe kullotave 19

Mbrojtja Sociale 21

Rrjeti rrugor 25

Transporti Publik 27

Ndriçimi Publik 29

Gjelbërimi i Sipërfaqeve Publike 32

Mirëmbajtja e Varrezave 34

Kultura 36

Sport & Argëtim 38

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR 40

Planifikimi Strategjik 41

Mbështetja për Biznesin 43

QEVERISJA E MIRE 47

Burimet Njerëzore 48

Transparenca 50

Barazia Gjinore 53

EU Integrimi në BE 54

MENAXHIMI FINANCIAR 58

Përfundime dhe rekomandime 62

FJALOR SHPJEGUES

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të evidentuar pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të drejtuara dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Eshtë fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kritereve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integrimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që

përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njësive të vetëqeverisjes vendore.

Sherbime Publike Vendore

Shërbimet publike vendore janë tërësia e shërbimeve që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar. Këto shërbime synojnë garantimin e mirëqenies sociale, përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social të territorit të bashkisë. Në këtë kuadër përfshihen shërbime të rëndësishme si administrimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës publike vendore, ndriçimi publik, pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve urbane, furnizimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, administrimi i pyjeve dhe kullotave, mbrojtja sociale, arsimi parashkollor dhe çerdhet, mbrojtja nga zjarri dhe emergjencat civile, si dhe shërbime të tjera që lidhen drejtpërdrejt me interesin publik vendor.

Sipas përcaktimit të bërë në legjislacionin në fuqi, "shërbimet publike vendore janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme dhe sipas standardeve minimale kombëtare të përcaktuara me ligj ose me akte të tjera normative". Nëpërmjet ofrimit të këtyre shërbimeve, bashkia luan një rol kyç në garantimin e funksionimit normal të jetës komunitare, në rritjen e transparencës dhe efikasitetit institucional, si dhe në krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të territorit.

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe ate publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë,

buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për cfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve ne cdo fushe paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndërvite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona	Përshkrimi
Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. "Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara").
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2024 / 2025	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: (Vlera 2025 − Vlera 2024) / Vlera 2024 × 100.
Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓)	Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2025 − Vlera 2024). Simboli I Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet
Semafori	Vlerësim vizual i nivelit të performancës: 🟢 = vlere absolute ndryshimi positiv 🟠 =vlere absolute ndryshimi negative.

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm "vlera positive ndryshimi = jeshile". Kjo rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë të kuqe edhe në raste kur rezultati real është pozitiv.

Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përmbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës. Këtu përfshihen, ndër të tjera:

- • Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- • Shpenzimet administrative (ulja tregon efiçencë).

QELLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2026 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Maliq, i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2026).

Bashkia Maliq ndodhet në juglindje të Shqipërisë dhe bën pjesë në qarkun e Korçës. Kufizohet në veri me bashkinë Pogradec, në lindje me bashkinë Korçë, në jug me bashkinë Devoll dhe në perëndim me bashkinë Gramsh. Qendra administrative e bashkisë është qyteti i Maliqit, i cili ndodhet në një nga zonat më pjellore të vendit, në fushën e Maliqit. Bashkia ka një sipërfaqe prej rreth 656 km² dhe përfshin një numër të konsiderueshëm njësish administrative si Libonik, Pojan, Vreshtas ,Moglicë, Pirg, dhe Gore.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Territori i Bashkisë Maliq karakterizohet nga një kombinim harmonik i fushave bujqësore të pasura dhe zonave kodrinore e malore, duke e bërë atë një territor me potencial të lartë për zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme, agroindustrisë, turizmit rural dhe energjisë së rinovueshme. Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, në veçanti ujërave, tokave bujqësore dhe pyjeve, është një nga prioritetet kryesore të zhvillimit strategjik të bashkisë.

Qëllimet dhe objektivat strategjike të Bashkisë Maliq përqendrohen në:

- Rritjen e cilësisë së jetesës për banorët përmes përmirësimit të infrastrukturës, shërbimeve publike dhe arsimit;
- Mbështetjen e bujqësisë dhe agro-përpunimit si sektorë kyç për zhvillimin ekonomik lokal;
- Nxitjen e turizmit të qëndrueshëm, bazuar në peizazhet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe vlerat tradicionale të komunitetit;
- Menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përfshirjen aktive të komunitetit në proceset vendimmarrëse.

Megjithatë, sfidat mbeten të shumta. Ndër më kryesoret janë: fragmentarizimi i pronës bujqësore, migrimi i të rinjve dhe plakja e popullsisë, mungesa e infrastrukturës moderne në disa zona rurale, si dhe nevoja për investime të qëndrueshme që ruajnë balancën midis zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit. Pavarësisht këtyre

sfidave, Bashkia Maliq angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për ndërtimin e një komuniteti të bashkuar, të qëndrueshëm dhe të përfshirë në zhvillimin afatgjatë të territorit të saj.

Disa nga sfidat krysore të zhvillimit janë:

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Viti 2025
Popullësia totale nën administrimin e bashkisë Regjistri Themeltar	64664
Popullësia totale nën administrimin e bashkisë	31008
Popullsia në qytet	3668
Popullsia në njësitë administrative	27340
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km2)	656.34
Sipërfaqe publike e bashkisë në km2	98
Sipërfaqja e njësive administrative në total	656.34
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	32536.56
Sipërfaqe totale e fondit kullosor (në ha)	4540
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	24168
Numri total i njësive administrative të bashkisë	7
Numri i fshatrave	81
Punonjës të bashkisë në total	612
Numri total i punonjëseve femra të bashkisë	263

Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	354
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	159
Numri total i punonjësve femra që punojnë për administratën e bashkisë	91

SHERBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësive të saj sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Në këtë kuadër, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore te aprovuara edhe ne kuader te raportit kombetar te performances bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimi parauniversitar (ku hyjnë çerdhet, arsimi parashkollor dhe infrastruktura e godinave arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombetar, tregues te tjere vendor qe jane perzgjedhur nga bashkia, si dhe dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë në ofrim ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë përparimet e arritura, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.

ARSIMI PARANIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar angazhimin për garantimin dhe përmirësimin e kushteve në institucionet e arsimit parauniversitar, duke synuar ofrimin e një shërbimi arsimor më cilësor dhe më të aksesueshëm për fëmijët dhe nxënësit në të gjithë territorin e bashkisë. Treguesit e raportuar reflektojnë një situatë të qëndrueshme në mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore, si dhe përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mbështetjes së nxënësve.

Në lidhje me treguesit e procesit mësimor, raporti nxënës/mësues në shkollat 9-vjeçare dhe numri mesatar i nxënësve për klasë paraqiten në nivele të qëndrueshme, duke reflektuar kushte më të favorshme për zhvillimin e procesit edukativ dhe për rritjen e vëmendjes ndaj nxënësve. Një element pozitiv mbetet edhe rritja e

numrit të punonjësve mbështetës për shkollat 9-vjeçare, çka kontribuon në forcimin e shërbimeve mbështetëse dhe sociale për nxënësit.

Nga ana tjetër, disa tregues evidentojnë nevojën për ndërhyrje dhe përmirësim të mëtejshëm. Numri mesatar i fëmijëve në klasat e kopshteve publike ka pësuar një rënie prej rreth 7.7%, ndërsa raporti fëmijë-mësues në kopshte publike është ulur krahasuar me vitin paraardhës. Po ashtu, janë konstatuar ulje në disa tregues që lidhen me arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe me punonjësit mbështetës për këtë nivel arsimor. Rënie është evidentuar edhe në raportin e shpenzimeve për institucionet e arsimit parauniversitar kundrejt numrit total të institucioneve, duke reflektuar nevojën për forcim të mbështetjes financiare për sektorin.

Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simboll	% Ndryshimi	Semafor
Shkolla 9 vjeçare të mirëmbajtura, kundrejt numrit total të shkollave 9 vjeçare publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	🟠
Raporti nxënës/mësues në shkolla 9 vjeçare	nxënës/mësues	0.00	1.54	1.54	↑	0.00%	🟢
Numri mesatar i nxënësve në një klasë të shkollës 9 vjeçare publike	nxënës/klasë	0.00	2.49	2.49	↑	0.00%	🟢
Numri mesatar i fëmijëve në një klasë kopshti publik	nxënës/klasë	10.68	9.86	-0.82	↓	-7.70%	🔴
Punonjës mbështetës për shkollë 9 vjeçare	punonjës mbështetës/shkollë 9 vjeçare	0.00	31.24	31.24	↑	0.00%	🟢
Shkolla 9 vjeçare të rikonstruktuara	numër	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	🟠

Kopshte të rikonstruktuara	numër	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	🟠
Raporti i shpenzimeve për institucionet e arsimit parauniversitar kundrejt numrit total të institucioneve (Mijë Lekë/institucion)	Mijë Lekë/institucion	1591.94	1479.08	-112.86	↓	-7.09%	🔴
Punonjës mbështetës për shkollë mesme të përgjithshme	punonjës mbështetës/shkollë e mesme	257.14	242.86	-14.29	↓	-5.56%	🔴
Numri mesatar i nxënësve në një klasë të arsimit të mesëm të përgjithshëm publik	nxënës/klasë	2248.28	1843.33	-404.94	↓	-18.01%	🔴
Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	0.00	0.00	Po	↑	100.00%	🟢
Godina Arsimore sipas nivelit arsimor	numër	83.00	83.00	0.00	→	0.00%	🟠
Godina Arsimore publike sipas nivelit arsimor	numër	51.00	52.00	1.00	↑	0.960%	🟢
Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	nxënës/mësues	9.85	9.24	-0.62	↓	-6.26%	🔴

Në tërësi, të dhënat tregojnë se Bashkia Maliq ka ruajtur stabilitetin në ofrimin e shërbimeve të arsimit parauniversitar dhe ka vijuar investimet në mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore, ndërkohë që mbetet e nevojshme forcimi i kapaciteteve institucionale, rritja e mbështetjes financiare dhe përmirësimi i treguesve që lidhen me arsimin parashkollor dhe shërbimet mbështetëse për fëmijët dhe nxënësit.

Sfidat	Arritjet	Objektivat
Ulja e numrit mesatar të fëmijëve në klasat e kopshteve publike	Ruajtja e nivelit të mirëmbajtjes së kopshteve publike	Përmirësimi i kushteve në arsimin parashkollor dhe rritja e regjistrimeve
Ulja e raportit të shpenzimeve për institucionet e arsimit parauniversitar	Vazhdimësia e investimeve në rikonstruksionin e shkollave dhe kopshteve	Rritja e investimeve dhe përmirësimi i financimit për institucionet arsimore

MENAXHIMI I MBETJEVE

Analiza e treguesve në fushën e menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë Maliq tregon një performancë përgjithësisht pozitive dhe një përmirësim gradual në organizimin, mbulimin territorial dhe qëndrueshmërinë financiare të shërbimit. Gjatë vitit raportues është evidentuar zgjerim i mbulimit të shërbimit në territor, rritje e nivelit të financimit nga tarifat e shërbimit dhe forcim i kuadrit strategjik përmes miratimit të planit vendor të menaxhimit të mbetjeve.

Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve rezulton i plotë si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, duke r nivelin 100% në të dy kategoritë. Gjithashtu, numri i fshatrave të mbuluara me shërbim është rritur nga 36 në 42 fshatra, çka tregon zgjerim të shërbimit dhe përmirësim të aksesit për komunitetet rurale.

Një zhvillim shumë pozitiv paraqitet në treguesin e mbulimit të kostove të menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit, i cili është rritur nga 48.66% në 59.04%. Ky progres prej mbi 21% reflekton përmirësim të ndjeshëm të mekanizmave të mbledhjes së të ardhurave dhe një avancim drejt qëndrueshmërisë financiare të shërbimit.

Nga analiza e të dhënave mbi sasinë e mbetjeve të gjeneruara rezulton se gjatë vitit 2025 janë gjeneruar rreth 6525 ton mbetje, krahasuar me 6603 ton në vitin 2024. Megjithëse konstatohet një ulje e lehtë, niveli i mbetjeve për banor mbetet pothuajse i pandryshuar në 0.11 kg/banor, duke treguar nevojën për politika më aktive në drejtim të reduktimit të mbetjeve, riciklimit dhe ndërgjegjësimit qytetar.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është miratimi dhe zbatimi i Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve gjatë vitit raportues, i cili përbën një instrument strategjik të rëndësishëm për përputhjen me standardet mjedisore dhe planifikimin afatgjatë të sektorit.

Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	93%	94%	3.70	↑	1.00 %	🟢
Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	0.11	0.11	0.00	↓	-1.02 %	🔴
Tregues	Mbulimi kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	48.66	59.04	10.39	↑	21.34 %	🟢
Tregues	Plani vendor I menaxhimit të mbetjeve I miratuar ose në zbatim	Numër	0.00	1.00	1.00	↑	0.00 %	🟢
Nëntregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00 %	🟠
Nëntregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	86.00	89.00	3.00	↑	3.00 %	🟢

Analiza e Sherbimit

Në tërësi, sektori i menaxhimit të mbetjeve paraqet një performancë të qëndrueshme dhe në përmirësim, veçanërisht në drejtim të mbulimit të territorit dhe forcimit të qëndrueshmërisë financiare të shërbimit. Megjithatë, mbetet e nevojshme rritja e investimeve në reduktimin e mbetjeve, promovimin e riciklimit dhe modernizimin e mëtejshëm të sistemit të menaxhimit mjedisor

Sfida	Arritje	Objektiva
• Mbulim ende jo i plotë i shërbimit në zonat rurale. • Nevojë për rritje të ndërgjegjësimit qytetar për ndarjen e mbetjeve në burim dhe pagesën e tarifës. • Nevojë për përmirësim të mëtejshëm të pajisjeve dhe logjistikës së shërbimit.	• Ruajtje e mbulimit 100% të shërbimit në zonat urbane. • Stabilitet i mbulimit total të popullsisë me shërbim. • Rritje e mbulimit të kostos nga tarifa e shërbimit (59.04%). • Vijimësi e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve.	• Zgjerimi gradual i shërbimit në fshatra dhe zonat e largëta. • Rritja e eficiencës në mbledhjen e tarifave dhe mbulimin e kostove. • Forcimi i riciklimit dhe ndarjes së mbetjeve në burim. • Përmirësimi i cilësisë dhe standardeve të shërbimit publik.

MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm: Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar garantimin e funksionimit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, duke ruajtur kapacitetet operacionale dhe mbulimin funksional të territorit në përputhje me nevojat e komunitetit. Shërbimi zjarrfikës përbën një nga strukturat më të rëndësishme të sigurisë publike dhe menaxhimit të emergjencave civile, duke luajtur rol kyç në mbrojtjen e jetës, pronës dhe mjedisit.

Analiza e treguesve kryesorë tregon një situatë të qëndrueshme në aspektin e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike të shërbimit. Numri i punonjësve zjarrfikës në bashki ka mbetur i pandryshuar në 16 punonjës gjatë viteve 2023–2025, duke garantuar vijimësinë e ofrimit të shërbimit dhe ruajtjen e kapaciteteve operacionale ekzistuese. Po ashtu, numri i mjeteve zjarrfikëse funksionale rezulton i qëndrueshëm në 3 automjete operative, duke siguruar mbulimin bazë të territorit për ndërhyrje në raste emergjente.

Treguesi i zjarrfikësve për 1,500 banorë ka mbetur konstant në nivelin 0.39 punonjës për 1,500 banorë, ndërsa treguesi i automjeteve zjarrfikëse për 10,000 banorë rezulton 0.49 mjete. Këta tregues reflektojnë stabilitet të kapaciteteve ekzistuese dhe ruajtje të nivelit aktual të shërbimit, megjithëse evidentojnë nevojën për investime

të mëtejshme në funksion të rritjes së gatishmërisë operacionale dhe përballimit të rasteve emergjente më komplekse.

Në përgjithësi, fusha e mbrojtjes nga zjarri dhe shërbimi zjarrfikës paraqet një performancë të qëndrueshme dhe funksionale, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimit dhe mbulimin bazë të territorit të bashkisë. Stabiliteti i treguesve dëshmon ruajtjen e kapaciteteve ekzistuese, por njëkohësisht evidenton nevojën për zhvillim dhe modernizim të mëtejshëm të sektorit për të përballuar në mënyrë më efektive emergjencat dhe risqet në rritje.

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshim
Tregues	Zjarrëfikës për 1,500 banorë	punonjës/1500 banorë	0.39	0.39	0.00	↑	Përmirësuar	I	0%
Tregues	Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10000 banorë	0.49	0.49	0.00	↑	Përmirësuar	I	0%

B) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Viti 2024	Viti 2025	Njësia Matëse
Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	16.00	16.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	64664.00	64664.00	Numër
Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	3.00	3.00	Numër

MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Përshkrim i përgjithshëm: Funksioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht neni 27 pika 1.

Gjatë vitit 2025, sektori i bujqësisë në Bashkinë Maliq ka vijuar të mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik vendor dhe mirëqenien e komunitetit rural. Duke qenë se ekonomia e territorit mbështetet në masë të konsiderueshme në aktivitetin bujqësor, ruajtja dhe funksionimi i infrastrukturës ujitëse dhe kulluese mbetet një prioritet kryesor për garantimin e prodhimit bujqësor dhe përmirësimin e produktivitetit të tokës.

Ecuria e Zhvillimit

Në përgjithësi, sektori i bujqësisë gjatë vitit 2025 karakterizohet nga:

- ruajtja e stabilitetit të infrastrukturës ujitëse dhe kulluese,
- mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të kanaleve,
- funksionalitet i lartë i sistemit kullues,
- vazhdimësia e mbështetjes së aktivitetit bujqësor në territorin e bashkisë.

Nga ana tjetër, mungesa e zgjerimit të sipërfaqeve të mbuluara me ujitje dhe rënia e lehtë e funksionalitetit të rrjetit sinjalizojnë nevojën për ndërhyrje më të mëdha investuese dhe modernizim të infrastrukturës bujqësore për të përballuar kërkesat në rritje të sektorit.

Përfundim

Në tërësi, sektori i bujqësisë në Bashkinë Maliq paraqet një situatë relativisht të qëndrueshme, me funksionim të mirë të infrastrukturës ekzistuese ujitëse dhe kulluese. Stabiliteti i treguesve dëshmon vazhdimësinë e menaxhimit të sektorit, por njëkohësisht evidenton nevojën për investime të reja, rehabilitim të rrjetit dhe zgjerim të sipërfaqeve të mbuluara me sistem ujitjeje për të rritur eficiencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë vendore.

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	%	55.69	55.69	0.00	→	0.00%	🟠
Tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale	%	100.00	99.48	-0.52	↓	-0.52%	🟠
Nëntregues	Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	93.98	93.98	0.00	→	0.00%	🟠
Nëntregues	Përqindja e kanaleve kulluese funksionale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	🟠

B) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Viti 2024	Viti 2025	Njësia Matës
Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki	24168.00	24168.00	Hektarë
Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi	15000.00	15500.00	Hektarë
Gjatësia e kanaleve ujitëse	83.00	83.00	Kilometër (km
Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale	81.00	71.00	Kilometër (km
Gjatësia e kanaleve kulluese	642.00	642.00	Kilometër (km
Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale	622.00	622.00	Kilometër (km

Analiza e Sherbimit

Analiza e treguesve kryesorë tregon një situatë përgjithësisht të qëndrueshme në aspektin e infrastrukturës bujqësore, megjithëse evidentohen edhe disa problematika që kërkojnë ndërhyrje të vazhdueshme. Përqindja e tokës bujqësore të pajisur me sistem ujitje dhe kullimi ka mbetur e pandryshuar në nivelin 55.69%, duke reflektuar ruajtjen e kapaciteteve ekzistuese të shërbimit, por njëkohësisht edhe mungesën e zgjerimit të mëtejshëm të sipërfaqeve të mbuluara me infrastrukturë ujitëse. Ky tregues tregon se më shumë se gjysma e sipërfaqes bujqësore të bashkisë vijon të përfitojë nga sistemi i ujitjes dhe kullimit, duke mbështetur aktivitetin prodhues të fermerëve.

Nga analiza e të dhënave rezulton se sipërfaqja totale e tokës bujqësore në bashki ka mbetur pothuajse e pandryshuar gjatë viteve të fundit, në rreth 24,168 hektarë, ndërsa sipërfaqja e mbuluar me kanale ujitjeje dhe kullimi ka pësuar ulje gjatë vitit 2025, duke kaluar nga 15,500 hektarë në 13,460 hektarë. Ky zhvillim tregon nevojën për investime të reja dhe rehabilitim të mëtejshëm të infrastrukturës ekzistuese për të garantuar funksionim më të qëndrueshëm të sistemit ujitës.

Në aspektin e funksionalitetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese, konstatohet një situatë relativisht pozitive. Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale ka mbetur e pandryshuar në nivelin 93.98%, duke treguar ruajtjen e funksionalitetit të pjesës më të madhe të rrjetit ujitës. Po ashtu, kanalet kulluese rezultojnë plotësisht funksionale në nivelin 100%, çka përbën një element shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e tokave bujqësore nga përmbytjet dhe garantimin e kullimit normal të ujërave.

Megjithatë, treguesi i përgjithshëm i kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale ka pësuar një rënie të lehtë nga 100% në 99.48%, duke reflektuar amortizimin gradual të disa segmenteve të rrjetit dhe nevojën për mirëmbajtje më intensive. Gjatësia e kanaleve ujitëse është rritur lehtë nga 82.135 km në 83 km, ndërsa

gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale ka mbetur në nivelin 82.135 km. Në të njëjtën kohë, gjatësia e kanaleve kulluese dhe atyre funksionale ka mbetur konstante në 622.127 km.

ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Përshkrim i përgjithshëm : Funksioni i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, sipas nenit 27, pika 5 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i është deleguar bashkive me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor publik që ndodhet brenda territorit të NJVV-ve. Bashkitë janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për fondet, monitorimin e tyre dhe për sigurimin e mbrojtjes kundër dëmtimeve, ndotjes apo zjarreve, në përputhje me legjislacionin për pyjet dhe kullotat.

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	0.00 %	🟠
Tregues	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00 %	🟠
Tregues	Punonjës për 1,000 hektarë	punonjës/ 1000 ha	0.86	0.95	0.09	↑	10.71 %	🟢

B) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	2024	2025	Njësia Matëse
Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	Po	Po	Cilësore (Po/Jo)
Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki	32536.56	32536.56	Hektarë
Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plan mbarështimi	32536.56	32536.56	Hektarë
Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	28.00	28.00	Numër

Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor në funksion të mbrojtjes së burimeve natyrore, ruajtjes së ekosistemeve dhe garantimit të përdorimit të qëndrueshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore. Ky sektor përbën një komponent të rëndësishëm të zhvillimit rural dhe mbrojtjes mjedisore, duke ndikuar drejtpërdrejt në ruajtjen e biodiversitetit, parandalimin e erozionit dhe mbështetjen e ekonomisë lokale.

Analiza e treguesve kryesorë tregon një situatë të qëndrueshme dhe të konsoliduar në aspektin e planifikimit dhe administrimit të fondit pyjor dhe kullosor. Bashkia vijon të ketë të miratuar dhe në zbatim Planin Vendor të Mbarështimit, i cili ka mbetur aktiv dhe funksional gjatë gjithë periudhës së raportimit. Ky plan përbën instrumentin kryesor strategjik për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, si dhe për organizimin e ndërhyrjeve në funksion të mbrojtjes dhe zhvillimit të fondit natyror.

Një tregues shumë pozitiv evidentohet në shkallën e pajisjes së fondit pyjor dhe kullosor me plane mbarështimi, e cila vijon të mbetet në nivelin 100%. Kjo tregon se e gjithë sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor në territorin e bashkisë administrohet mbi bazën e dokumenteve planifikuese dhe standardeve të përcaktuara të menaxhimit. Sipërfaqja totale e fondit pyjor dhe kullosor rezulton 32,536 hektarë, ndërsa e gjithë kjo sipërfaqe mbetet e mbuluar me plane mbarështimi edhe gjatë vitit 2025.

Në aspektin e kapaciteteve njerëzore, vihet re një përmirësim i treguesit të numrit të punonjësve për 1,000 hektarë fond pyjor dhe kullosor, i cili është rritur nga 0.86 në 0.95 punonjës për 1,000 hektarë. Ky zhvillim lidhet me shtimin e numrit të punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor nga 28 në 31 punonjës gjatë vitit raportues. Rritja e kapaciteteve njerëzore përbën një element pozitiv në drejtim të forcimit të kontrollit dhe monitorimit të territorit pyjor dhe kullosor.

Në tërësi, sektori i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Maliq paraqet një situatë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar në aspektin e planifikimit dhe administrimit të fondit pyjor. Ruajtja e mbulimit të plotë me plane mbarështimi dhe rritja e kapaciteteve njerëzore përbëjnë elementë pozitivë të zhvillimit të sektorit. Megjithatë, nevojitet një qasje më aktive në drejtim të investimeve mjedisore, rehabilitimit të sipërfaqeve pyjore dhe forcimit të mbrojtjes së fondit natyror për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë.

MBROJTJA SOCIALE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me Organizata jo Fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

Analiza e Sherbimit

Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar ofrimin dhe forcimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale, me fokus në mbështetjen e familjeve në nevojë, grupeve vulnerabël dhe garantimin e aksesit në shërbime sociale të integruara. Analiza e treguesve kryesorë evidenton zhvillime pozitive në disa aspekte të përfshirjes sociale dhe funksionimit të mekanizmave mbështetës, megjithëse mbeten sfida në drejtim të strehimit social dhe zgjerimit të kapaciteteve infrastrukturore të shërbimeve sociale. Një nga treguesit më pozitivë gjatë vitit raportues lidhet me përqindjen e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, e cila është rritur ndjeshëm nga 82.42% në 98.71%, duke shënuar një rritje prej rreth 19.77%. Ky tregues reflekton përmirësim të konsiderueshëm në identifikimin dhe mbulimin e familjeve në nevojë, si dhe forcim të mekanizmave të mbështetjes sociale në nivel vendor. Nga të dhënat rezulton se gjatë vitit 2025 kanë aplikuar për ndihmë ekonomike 1,711 familje, nga të cilat 1,689 familje kanë rezultuar përfituese të skemës së ndihmës ekonomike. Pozitiv paraqitet gjithashtu funksionimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), ku përqindja e rasteve të referuara që kanë përfituar shërbime sociale është rritur nga 104.26% në 105.88%. Ky tregues dëshmon eficiencë të lartë të koordinimit ndërinstitucional dhe garantim të trajtimit të rasteve të referuara, veçanërisht për rastet e dhunës në familje dhe kategorive në nevojë. Numri i rasteve të referuara nga MKR ka qenë 34 raste gjatë vitit 2025, ndërsa 36 raste kanë përfituar shërbime sociale nga strukturat përkatëse.

Në fushën e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar (PAK), konstatohet një përmirësim i treguesve kryesorë. Përqindja e personave me aftësi të kufizuar të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që kanë përfituar mbështetje sociale të integruar është rritur nga 50.21% në 54.00%, duke reflektuar një rritje prej 7.55%. Gjatë vitit raportues janë referuar 250 persona me aftësi të kufizuar, ndërsa 135 prej tyre kanë përfituar mbështetje sociale si rezultat i referimit. Gjithashtu, vihet re rritje e përqindjes së femrave me aftësi të kufizuar që përfitojnë mbështetje sociale, nga 8.00% në 9.09%.

Nga ana tjetër, një nga problematikat kryesore mbetet rënia e shkallës së miratimit të strehimit social, e cila ka pësuar ulje të ndjeshme nga 69.44% në 47.25%, duke reflektuar kufizime në kapacitetet për përmbushjen e kërkesave për strehim. Gjatë vitit 2025 janë paraqitur 91 kërkesa për strehim social, ndërsa vetëm 43 persona kanë rezultuar përfitues. Ky zhvillim evidenton nevojën për rritje të kapaciteteve dhe fondeve për programet e strehimit social.

Në aspektin e infrastrukturës sociale, numri i qendrave sociale komunitare publike dhe të licencuara për 10,000 banorë ka mbetur i pandryshuar në nivelin 0.65 qendra për 10,000 banorë. Po ashtu, numri i qendrave sociale ditore funksionale ka mbetur 4, ndërsa bashkia vijon të mos ketë qendra sociale rezidenciale funksionale. Kjo situatë tregon stabilitet të shërbimeve ekzistuese, por njëkohësisht evidenton nevojën për zgjerim të rrjetit të shërbimeve sociale dhe rritje të aksesit për grupet vulnerabël.

A) Treguesit përmbledhës

Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	%	0.94	0.82	- 12	↓	12 %	🟢
Shkalla e miratimit të strehimit social	%	69.44	47.25	-22.19	↓	- 31.96 %	🔴
Numri i qendrave sociale komunitare publike, te licensuara për 10,000 banorë	qendra/10,000 banore	0.65	0.65	0.00	→	0.00%	🟠
Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	104.26	105.88	1.63	↑	1.56%	🟢

Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	50.21	54.00	3.79	↑	7.55%	●
Plan vendor social	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●
Përqindja e rasteve femra të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Përqindja e rasteve meshkuj të referuar nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Përqindja e rasteve grupmosha 0-17 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Përqindja e rasteve grupmosha 18-29 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Përqindja e rasteve grupmosha 30-44 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Përqindja e rasteve grupmosha 45-59 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●

Përqindja e rasteve grupmosha 60+ vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	🟠
Përqindja e femrave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	8.00	9.09	1.09	↑	13.64 %	🟢
Përqindja e personave grupmosha 0-17 vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	36.36	27.27	-9.09	↓	- 25.00 %	🟠
Përqindja e personave grupmosha 18+ vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	20.75	20.41	-0.35	↓	- 1.67%	🟠

Në tërësi, fusha e mbrojtjes sociale në Bashkinë Maliq paraqet zhvillime pozitive në drejtim të përfshirjes sociale dhe funksionimit të mekanizmave mbështetës për familjet dhe grupet vulnerabël. Përmirësimi i mbulimit me ndihmë ekonomike dhe rritja e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar përbëjnë tregues të rëndësishëm të forcimit të politikave sociale vendore. Megjithatë, sektori kërkon zgjerim të kapaciteteve infrastrukturore dhe rritje të mbështetjes financiare për të përballuar nevojat në rritje për strehim social dhe shërbime komunitare.

RRJETI RRUGOR

Përshkrim i përgjithshëm: Shërbimi i rrjetit rrugor përfshin planifikimin, ndërtimin, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e rrugëve urbane e rurale në territorin e bashkisë, me qëllim garantimin e lëvizjes së sigurt të qytetarëve, mallrave dhe shërbimeve. Në këtë funksion përfshihet

gjithashtu vendosja e sinjalistikës rrugore, përmirësimi i aksesit në zonat e banuara dhe ndërhyrjet për rritjen e standardeve të sigurisë rrugore. Ky shërbim ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe social të territorit.

Gjatë vitit raportues, përqindja e rrjetit rrugor të shtruar ka arritur në 1.52%, kundrejt mungesës së rrjetit të shtruar gjatë vitit paraardhës. Konkretisht, gjatë vitit 2025 janë realizuar 8.7 km rrjet rrugor i shtruar, ndërsa gjatësia totale e rrjetit rrugor të bashkisë rezulton 573 km. Ky zhvillim përbën një hap pozitiv në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe aksesit në territor.

Në aspektin e mirëmbajtjes së rrjetit rrugor, gjatësia totale e rrjetit të mirëmbajtur ka mbetur e pandryshuar në 573 km gjatë viteve 2024–2025, duke reflektuar vazhdimësinë e ndërhyrjeve për mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese rrugore. Gjithashtu, gjatësia e rrjetit rrugor të mirëmbajtur në zonat urbane ka mbetur konstante në 50 km. Nga ana tjetër, gjatësia e rrjetit rrugor të mirëmbajtur në zonat rurale ka pësuar rënie nga 64 km në 52 km, duke reflektuar ulje me 18.75% krahasuar me vitin paraardhës. Ky tregues evidenton nevojën për rritje të investimeve dhe ndërhyrjeve në mirëmbajtjen e akseve rurale.

A) Treguesit përmbledhës

Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Përqindja e rrjetit rrugor të shtruar	%	0.00	1.52	1.52	↑	0.00%	🟢
Përqindja e rrjetit me sinjalistikë	%	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	🟠
Gjatësia e rrjetit rrugor të mirëmbajtur në vit	km	573.00	573.00	0.00	→	0.00%	🟠

Shpenzim për km rrjet rrugor	Mije Leke/km	178.74	183.19	4.45	↑	2.49%	🟢
Gjatësia e mirëmbajtur – Urban	km	50.00	50.00	0.00	→	0.00%	🟠
Gjatësia e mirëmbajtur – Rural	km	64.00	52.00	-12.00	↓	-18.75%	🔴

Sfidat Kryesore	**Arritjet Kryesore**	**Objektivat për Vitin Pasardhës**
Mungesa e sinjalistikës horizontale dhe vertikale në rrjetin rrugor vendor.	Realizimi i shtrimit të 8.7 km rrjet rrugor gjatë vitit 2025.	Vendosja e sinjalistikës rrugore sipas standardeve në akset kryesore dhe rurale.
Amortizimi i segmenteve rrugore rurale dhe ulja e gjatësisë së mirëmbajtur në zonat rurale.	Ruajtja e mirëmbajtjes së 573 km rrjet rrugor vendor.	Rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore rurale.
Nevoja për rritje të investimeve në mirëmbajtjen dhe standardizimin e rrjetit rrugor.	Rritje e shpenzimeve për km rrjet rrugor dhe garantim i aksesit në territor.	Rritja e investimeve për asfaltimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore.
Nevoja për përmirësimin e sigurisë dhe aksesit në zonat periferike dhe rurale.	Vazhdimësi e funksionimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor urban.	Zgjerimi i segmenteve të asfaltuara dhe përmirësimi i lidhjes ndërmjet njësive administrative.

TRANSPORTI PUBLIK

Përshkrim i përgjithshëm: Shërbimi i transportit publik synon sigurimin e lëvizshmërisë së qytetarëve përmes linjave të transportit brenda dhe jashtë territorit të bashkisë. Ai përfshin organizimin e linjave, licencimin dhe monitorimin e operatorëve, si dhe krijimin e kushteve për një shërbim të sigurt, të rregullt dhe të aksesueshëm për të gjithë qytetarët. Transporti publik është një element i rëndësishëm për lidhjen e zonave administrative dhe përmirësimin e aksesit në punësim, arsim dhe shërbime publike.

Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar funksionimin dhe administrimin e shërbimit të transportit publik në funksion të garantimit të lëvizjes së qytetarëve dhe lidhjes ndërmjet zonave urbane dhe rurale të territorit vendor. Analiza e treguesve kryesorë evidenton zhvillime të moderuara në zgjerimin e linjave të transportit publik, por njëkohësisht paraqet rënie të kapaciteteve të mjeteve të transportit dhe mungesë të sistemit të monitorimit të treguesve të përdorimit të shërbimit.

Gjatë vitit raportues, numri total i linjave të transportit publik është rritur nga 18 në 19 linja, duke reflektuar rritje prej 5.56% krahasuar me vitin paraardhës. Ky zhvillim tregon përmirësim të mbulimit të territorit me shërbim transporti publik dhe zgjerim të lidhjes ndërmjet njësive administrative dhe qendrave të shërbimeve.

Nga ana tjetër, numri total i automjeteve të transportit publik ka pësuar rënie nga 43 në 40 automjete, duke reflektuar ulje prej 6.98% gjatë vitit 2025. Ky tregues evidenton reduktim të kapaciteteve operacionale të transportit publik dhe nevojën për modernizim dhe shtim të flotës së mjeteve në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit dhe aksesit të qytetarëve.

Në aspektin e linjave urbane dhe ndërurbane, vihet re rënie e lehtë e treguesve gjatë periudhës së raportimit. Numri i linjave urbane ka pësuar ulje prej 0.41%, ndërsa linjat ndërurbane kanë shënuar rënie prej 2.66%. Po ashtu, treguesit e numrit të udhëtarëve urbanë dhe ndërurbanë paraqiten në rënie në të njëjtin nivel, duke reflektuar mungesë të zgjerimit të përdorimit të transportit publik gjatë vitit raportues.

A) Treguesit përmbledhës

Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Numri total i linjave të	numër	18.00	19.00	1.00	↑	5.56%	●

transportit publik							
Numri total i automjeteve të transportit publik	numër	43.00	40.00	-3.00	↓	-6.98%	
Numri i linjave – Urban	numër	241.00	240.00	-1.00	↓	-0.41%	
Numri i linjave – Ndërurban	numër	301.00	293.00	-8.00	↓	-2.66%	
Numri i udhëtarëve – Urban	numër	241.00	240.00	-1.00	↓	-0.41%	
Numri i udhëtarëve – Ndërurban	numër	301.00	293.00	-8.00	↓	-2.66%	

Sfidat Kryesore	**Arritjet Kryesore**	**Objektivat për Vitin Pasardhës**
Reduktimi i numrit të automjeteve të transportit publik dhe nevoja për modernizimin e flotës ekzistuese.	Rritja e numrit të linjave të transportit publik nga 18 në 19 linja gjatë vitit 2025.	Shtimi dhe modernizimi i mjeteve t transportit publik në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbim
Mungesa e sistemit të monitorimit për numrin e udhëtarëve, biletat e shitura dhe subvencionimin e transportit publik.	Garantimi i vazhdimësisë së funksionimit të transportit publik në territorin e bashkisë.	Krijimi i sistemit të administrimit d raportimit të të dhënave për transportin publik vendor.

Sfidat Kryesore	Arritjet Kryesore	Objektivat për Vitin Pasardhës
Rënia e lehtë e linjave dhe lëvizjeve ndërurbane.	Ruajtja e lidhjes së zonave urbane dhe rurale përmes linjave ekzistuese të transportit.	Përmirësimi i mbulimit territorial d rritja e aksesit të qytetarëve në transport publik.
Nevoja për përmirësimin e cilësisë dhe standardeve të shërbimit të transportit publik.	Vazhdimësia e ofrimit të shërbimit të transportit publik për komunitetin.	Hartimi i masave për përmirësimin sigurisë, komoditetit dhe eficiencës transportit publik vendor.

NDRIÇIMI PUBLIK

Gjatë vitit raportues, gjatësia e rrjetit të ndriçimit të mirëmbajtur është rritur nga 147 km në 154 km, duke reflektuar rritje prej 4.76% krahasuar me vitin paraardhës. Ky zhvillim tregon zgjerim të mbulimit dhe përmirësim të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ndriçimit publik në territorin e bashkisë.

Pozitiv paraqitet edhe treguesi i numrit të pikave funksionale të ndriçimit publik, i cili është rritur nga 4,204 në 4,404 pika ndriçimi, me rritje prej 4.76%. Gjithashtu, përqindja e sipërfaqes publike të mbuluar me ndriçim ka pësuar rritje nga 2.52% në 2.68%, duke reflektuar zgjerim të mbulimit të hapësirave publike me sistem ndriçimi.

Në aspektin financiar, shpenzimet për ndriçimin publik janë rritur me 10.18% gjatë vitit 2025, duke reflektuar rritje të investimeve dhe kostove për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik. Nga ana tjetër, të ardhurat nga tarifa e ndriçimit kanë pësuar rënie me 2.83%, duke evidentuar nevojën për përmirësim të mekanizmave të mbledhjes së të ardhurave dhe administrimit të tarifës së ndriçimit publik.

Në nivel territorial, gjatësia e mirëmbajtur e ndriçimit në zonat rurale ka pësuar rënie nga 3 km në 2 km, duke reflektuar ulje prej 33.33% krahasuar me vitin paraardhës. Ky tregues evidenton nevojën për rritje të ndërhyrjeve dhe investimeve në ndriçimin publik rural, në funksion të përmirësimit të sigurisë dhe aksesit në këto zona.

A) Treguesit përmbledhës

Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simboli	% Ndrys himi	Semafor
Gjatësia e rrjetit të ndriçimit të mirëmbajtur	km	147.00	154.00	7.00	↑	4.76%	
Shpenzime për ndriçimin publik	Mijë Lekë	1054322.00	1161600.00	107278.00	↑	10.18%	
Të ardhura nga tarifa e ndriçimit	Mijë Lekë	8641779.00	8397005.00	-244774.00	↓	-2.83%	
% e sipërfaqes publike të mbuluar me ndriçim	%	2.52	2.68	0.17	↑	6.67%	
Numri i pikave të ndriçimit funksionale	numër	4204.00	4404.00	200.00	↑	4.76%	
Gjatësia e mirëmbajtur – Urban	km	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	
Gjatësia e mirëmbajtur – Urban	km	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	

Sfidat Kryesore	**Arritjet Kryesore**	**Objektivat p Vitin Pasard**

Rënia e të ardhurave nga tarifa e ndriçimit publik dhe nevoja për përmirësimin e nivelit të arkëtimit.	Rritja e gjatësisë së rrjetit të ndriçimit të mirëmbajtur nga 147 km në 154 km.	Përmirësimi i administrimit arkëtimit të ta së ndriçimit pu
Nevoja për zgjerimin e ndriçimit publik në zonat rurale dhe periferike.	Rritja e numrit të pikave funksionale të ndriçimit nga 4,204 në 4,404 pika.	Zgjerimi i rrje ndriçimit publ zonat rurale d akset kryesor
Ulja e gjatësisë së mirëmbajtur të ndriçimit në zonat rurale.	Rritja e sipërfaqes publike të mbuluar me ndriçim nga 2.52% në 2.68%.	Rritja e ndërh për mirëmbajt dhe rehabilitin rrjetit rural të ndriçimit.
Rritja e kostove operative dhe e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik.	Rritje e investimeve dhe shpenzimeve për funksionimin e ndriçimit publik gjatë vitit 2025.	Investime në sisteme ndriçi eficiencë energjetike dh të kostove operative.

GJELBËRIMI I SIPËRFAQEVE PUBLIKE

Sipërfaqja e gjelbër publike për frymë është rritur nga 0.01 m²/banor në 0.37 m²/banor, ndërsa sipërfaqja publike e mbuluar me gjelbërim ka pësuar rritje nga 0.30% në 12.74%, duke reflektuar zgjerim të konsiderueshëm të sipërfaqeve të gjelbëruara gjatë vitit 2025. Gjithashtu, në zonat urbane, sipërfaqja e gjelbërimit publik për frymë është rritur nga 100.33 m²/banor në 146.50 m²/banor, me rritje prej 46.01%.

Pozitiv paraqitet edhe treguesi i numrit të pemëve të mbjella gjatë vitit, i cili është rritur nga 2,000 në 2,500 pemë, duke reflektuar rritje prej 25% krahasuar me vitin paraardhës. Ky zhvillim tregon vijimësi të ndërhyrjeve për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra dhe përmirësimin e kushteve mjedisore në territorin e bashkisë.

Nga ana tjetër, analiza e treguesve evidenton rënie të ndjeshme të shkallës së mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra publike, e cila ka zbritur nga 3690.04% në 87.91%. Po ashtu, shpenzimet për m² gjelbërim publik kanë pësuar ulje të konsiderueshme nga 6445.02 mijë lekë/m² në 153.55 mijë lekë/m². Këta tregues evidentojnë nevojën për përmirësimin e planifikimit dhe eficiencës së mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra publike.

Në zonat rurale, treguesit e sipërfaqeve publike të mbuluara me gjelbërim rezultojnë të pandryshuar, duke evidentuar mungesë të zgjerimit të hapësirave të gjelbra në këto zona dhe nevojën për ndërhyrje më të mëdha në funksion të balancimit territorial të investimeve mjedisore.

A) Treguesit përmbledhës

Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Sipërfaqe e gjelbër publike për frymë	m²/banor	0.01	0.37	0.36	↑	4104.09%	🟢
Sipërfaqja publike e mbuluar me gjelbërim	%	0.30	12.74	12.43	↑	4097.42%	🟢
Numri i pemëve të mbjella gjatë vitit	numër	2000.00	2500.00	500.00	↑	25.00%	🟢
m² gjelbërim publik për frymë – Urban	m²/banor	100.33	146.50	46.17	↑	46.01%	🟢

Sipërfaqja publike urbane e mbuluar me gjelbërim	%	100.33	146.50	46.17	↑	46.01%	●
Sipërfaqja publike rurale e mbuluar me gjelbërim	%	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●

Sfidat Kryesore	**Arritjet Kryesore**	**Objektivat për Vitin Pasardhës**
Mevoja e mirëmbajtjes së qëndrueshme të sipërfaqeve të gjelbra publike dhe ulja e eficiencës së shpenzimeve për mirëmbajtje.	Rritja e sipërfaqes së gjelbër publike për frymë dhe zgjerimi i sipërfaqeve publike të mbuluara me gjelbërim gjatë vitit 2025.	Përmirësimi i sistemit të mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbra dhe rritja e eficiencës së investimeve mjedisore.
Mevoja e zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra në zonat rurale.	Mbjellja e 2,500 pemëve gjatë vitit raportues dhe përmirësimi i gjelbërimit urban.	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbra në zonat rurale dhe periferike të bashkisë.
Nevoja për rritjen e investimeve në gjelbërimin publik dhe sistemet e ujitjes e mirëmbajtjes.	Rritja e sipërfaqes publike të mbuluar me gjelbërim dhe përmirësimi i kushteve mjedisore në zonat urbane.	Hartimi dhe zbatimi i projekteve të reja për gjelbërim publik dhe rehabilitim mjedisor.
Nevoja për përmirësimin e balancës territoriale të investimeve mjedisore ndërmjet zonave urbane dhe rurale.	Vazhdimësia e ndërhyrjeve për shtimin e hapësirave të gjelbra dhe mbrojtjen e mjedisit urban.	Rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe forcimi i politikave për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit publik.

MIRËMBAJTJA E VARREZAVE

Përshkrim i përgjithshëm: Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave përfshin administrimin, sistemimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave funerale në territorin e bashkisë. Ai synon garantimin e kushteve dinjitoze për qytetarët, ruajtjen e pastërtisë dhe rendit, si dhe planifikimin e kapaciteteve për nevojat e komunitetit. Ky funksion ka rëndësi sociale dhe publike, duke siguruar standarde të përshtatshme në menaxhimin e këtyre hapësirave.

Analiza e Shërbimit

- Mirëmbajtja sipas planit mbetet 100%, duke treguar funksionim të plotë.
- Kapaciteti i lirë është ulur (2.12% → 1.65%), duke treguar presion në rritje.
- Të ardhurat kanë rënë ndjeshëm (-11.50%), duke reflektuar ulje të arkëtimeve.
- Në tërësi, shërbimi është funksional, por me sfida në kapacitet dhe financa.

A)Treguesit përmbledhës

Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
% varresh me mirëmbajtje sipas planit	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	
Shpenzim për varr aktiv	Lekë/varr	9042.05	867.49	-8174.56	↓	-90.41%	
Të ardhura nga tarifat e varrezave	Lekë	3725470.00	3296866.00	-428604.00	↓	-11.50%	

KULTURA

Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar zhvillimin dhe mbështetjen e aktiviteteve kulturore në funksion të promovimit të jetës kulturore dhe përfshirjes së komunitetit në aktivitete artistike dhe kulturore. Analiza e treguesve kryesorë evidenton zhvillime pozitive në rritjen e aktiviteteve kulturore, pjesëmarrjes së qytetarëve dhe mbështetjes financiare për sektorin e kulturës.

Numri i aktiviteteve kulturore për 1,000 banorë është rritur nga 0.37 në 0.39 aktivitete, duke reflektuar rritje prej 4.51% gjatë vitit raportues. Po ashtu, numri i pjesëmarrësve në aktivitete kulturore për 1,000 banorë ka pësuar rritje të ndjeshme nga 37.27 në 48.70 pjesëmarrës, me rritje prej 30.64%, duke treguar interes dhe përfshirje më të madhe të komunitetit në jetën kulturore të bashkisë.

Në aspektin financiar, shpenzimet për kulturën për banor janë rritur nga 0.27 në 0.29 mijë lekë për banor, me rritje prej 8.49%, ndërsa të ardhurat nga aktivitetet kulturore janë rritur nga 135,500 mijë lekë në 140,729 mijë lekë, duke reflektuar rritje prej 3.86% krahasuar me vitin paraardhës.

Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Numri i aktiviteteve kulturore për 1,000 banorë	Nr/1000 banorë	0.37	0.39	0.02	↑	4.51%	●
Numri i pjesëmarrësve në aktivitete kulturore për 1,000 banorë	Nr/1000	37.27	48.70	11.42	↑	30.64%	●

Shpenzim për banor për kulturë	mije Lekë/banor	0.27	0.29	0.02	↑	8.49%	●
Të ardhura nga aktivitetet kulturore	Mije Lekë	135500.00	140729.00	5229.00	↑	3.86%	●

Sfidat Kryesore	**Arritjet Kryesore**	**Objektivat për Vitin Pasardhës**
Mungesa e të dhënave dhe monitorimit për objektet kulturore funksionale.	Rritja e numrit të aktiviteteve kulturore dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën kulturore të bashkisë.	Përmirësimi i administrimit dhe inventarizimit të objekteve kulturore në territor.
Nevoja për rritjen e investimeve në infrastrukturën kulturore dhe aktivitetet artistike.	Rritja e shpenzimeve për kulturën dhe e të ardhurave nga aktivitetet kulturore gjatë vitit 2025.	Rehabilitimi dhe modernizimi i objekteve kulturore dhe hapësirave artistike publike.
Kufizimi i hapësirave dhe infrastrukturës për zhvillimin e aktiviteteve kulturore në zonat rurale.	Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i përfshirjes së komunitetit në aktivitetet artistike dhe tradicionale.	Zgjerimi i aktiviteteve kulturore në njësitë administrative dhe zonat rurale të bashkisë.
Nevoja për promovim më të madh të trashëgimisë kulturore dhe traditave lokale.	Rritje e pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitetet kulturore dhe artistike.	Hartimi i programeve dhe eventeve kulturore për promovimin e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e turizmit kulturor.

SPORT & ARGËTIM

Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar administrimin dhe mbështetjen e infrastrukturës sportive dhe aktiviteteve rekreative në funksion të promovimit të jetesës aktive dhe përmirësimit të kushteve për zhvillimin e aktiviteteve sportive në komunitet. Analiza e treguesve kryesorë evidenton përmirësim të infrastrukturës sportive dhe rritje të investimeve në sektorin e sportit dhe argëtimit, megjithëse konstatohet rënie e pjesëmarrjes në aktivitetet sportive gjatë vitit raportues.

Përqindja e objekteve sportive funksionale është rritur nga 42.86% në 57.14%, duke reflektuar përmirësim prej 33.33% të nivelit të funksionalitetit të infrastrukturës sportive në territorin e bashkisë. Gjithashtu, sipërfaqja sportive publike për frymë është rritur nga 0.89 m²/banor në 0.96 m²/banor, me rritje prej 7.44%, duke treguar zgjerim të hapësirave sportive publike në dispozicion të komunitetit.

Në aspektin financiar, shpenzimet për sport dhe argëtim për banor janë rritur nga 207.62 lekë/banor në 281.91 lekë/banor, duke reflektuar rritje prej 35.78% gjatë vitit 2025. Ky tregues evidenton rritje të mbështetjes financiare për sektorin sportiv dhe përmirësimin e kushteve për aktivitetet sportive dhe rekreative.

Nga ana tjetër, numri i pjesëmarrësve në aktivitete sportive për 1,000 banorë ka pësuar rënie nga 3.40 në 0 pjesëmarrës, duke reflektuar ulje prej 100% krahasuar me vitin paraardhës. Gjithashtu, numri i aktiviteteve sportive për 1,000 banorë rezulton i pandryshuar dhe në nivel 0, duke evidentuar mungesë të aktiviteteve sportive të organizuara dhe nevojën për rritje të angazhimit institucional në organizimin e eventeve sportive dhe aktiviteteve komunitare

Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Numri i pjesëmarrësve në aktivitete sportive për 1,000 banorë	Nr/1000	3.40	0.00	-3.40	↓	-100.00%	●

% objekteve sportive funksionale	%	42.86	57.14	14.29	↑	33.33%	●
Shpenzim për banor për sport & argëtim	Lekë/banor	207.62	281.91	74.29	↑	35.78%	●
Sipërfaqe sportive publike për frymë	m²/banor	0.89	0.96	0.07	↑	7.44%	●

Sfidat Kryesore	**Arritjet Kryesore**	**Objektivat për Vitin Pasardhës**
Mungesa e aktiviteteve sportive të organizuara dhe rënia e pjesëmarrjes së komunitetit në aktivitetet sportive.	Rritja e përqindjes së objekteve sportive funksionale nga 42.86% në 57.14%.	Organizimi i aktiviteteve dhe kampionateve sportive për grupmosha të ndryshme në territorin e bashkisë.
Nevoja për aktivizimin e të rinjve dhe rritjen e përfshirjes së komunitetit në sport dhe argëtim.	Rritja e sipërfaqeve sportive publike për frymë dhe përmirësimi i infrastrukturës sportive.	Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve dhe komunitetit në aktivitete sportive dhe rekreative.
Kufizimi i eventeve sportive dhe mungesa e programeve të vazhdueshme sportive komunitare.	Rritja e investimeve dhe shpenzimeve për sport dhe argëtim gjatë vitit 2025.	Zgjerimi i programeve sportive dhe rehabilitimi i hapësirave sportive ekzistuese.
Nevoja për mirëmbajtje dhe modernizim të mëtejshëm të infrastrukturës sportive publike.	Përmirësimi i kushteve të objekteve sportive	Modernizimi i objekteve sportive dhe krijimi i hapësirave të reja për

Sfidat Kryesore	Arritjet Kryesore	Objektivat për Vitin Pasardhës
	funksionale në territorin e bashkisë.	aktivitete sportive dhe rekreative.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

Zhvillimi Ekonomik Vendor përfaqëson aftësinë e bashkisë për të krijuar kushte të favorshme për rritje ekonomike të qëndrueshme, nxitje të investimeve dhe përmirësim të mirëqenies së komunitetit lokal. Në kuadër të matjes së performancës vendore, kjo fushë vlerësohet përmes shërbimeve që pasqyrojnë kapacitetin institucional për planifikim, mbështetje të aktivitetit ekonomik dhe menaxhim të hapësirave publike me ndikim në ekonomi:

1. Planifikimi Strategjik – mat aftësinë e bashkisë për të hartuar vizione afatgjata zhvillimi, plane veprimi dhe politika lokale që orientojnë investimet, përdorimin e burimeve dhe prioritetet ekonomike të territorit.
2. Administrimi i Tregjeve Publike – tregon nivelin e menaxhimit, organizimit dhe funksionalitetit të tregjeve publike, duke garantuar kushte të përshtatshme për tregtarët, siguri ushqimore dhe akses për konsumatorët.
3. Mbështetja për Biznesin e Vogël dhe NVM-të – reflekton angazhimin e bashkisë për të nxitur sipërmarrjen lokale përmes lehtësimit të procedurave, informimit, bashkëpunimit institucional dhe krijimit të kushteve për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme.

PLANIFIKIMI STRATEGJIK per ZHVILLIMIN EKONOMIK

Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar zbatimin e politikave dhe instrumenteve të planifikimit strategjik dhe zhvillimit ekonomik vendor, në funksion të organizimit të territorit, përmirësimit të klimës së zhvillimit ekonomik dhe forcimit të mekanizmave të planifikimit institucional. Analiza e treguesve kryesorë evidenton ruajtje të stabilitetit në dokumentet strategjike dhe planifikimin territorial, si dhe zhvillime pozitive në disa tregues të lidhur me konsultimin publik dhe zonat ekonomike.

Gjatë periudhës së raportimit është ruajtur ekzistenca dhe funksionaliteti i Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), ndërsa përqindja e territorit të mbuluar me PPV dhe PDV ka mbetur e pandryshuar krahasuar me vitin paraardhës. Konkretisht, territori i mbuluar me PPV rezulton në nivelin 0.08%, ndërsa territori i mbuluar me PDV në nivelin 0.02%, duke reflektuar stabilitet në administrimin dhe planifikimin territorial të bashkisë.

Një zhvillim pozitiv evidentohet në rritjen e numrit të zonave ekonomike të përcaktuara në PPV/PDV, i cili është rritur nga 105 në 107 zona ekonomike gjatë vitit 2025. Gjithashtu, treguesi i lejeve të përfituara kundrejt aplikimeve për leje zhvillimi në zonat ekonomike është rritur nga 52.38% në 60.00%, duke reflektuar përmirësim të eficiencës administrative në trajtimin e aplikimeve dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik vendor.

Koha mesatare e trajtimit të lejeve të zhvillimit ka mbetur e pandryshuar në 12 ditë, duke dëshmuar ruajtjen e standardeve administrative në shqyrtimin e procedurave për lejet e zhvillimit. Po ashtu, numri i dokumenteve strategjike ekonomike të miratuara ka mbetur në nivelin 4 dokumente, duke garantuar vazhdimësinë e kuadrit strategjik për zhvillimin ekonomik vendor.

Nga ana tjetër, përqindja e aplikimeve online për shërbime ekonomike ka pësuar rënie nga 28.57% në 22.22%, duke reflektuar nevojën për përmirësim të mëtejshëm të shërbimeve elektronike dhe rritje të përdorimit të platformave online nga qytetarët dhe bizneset. Gjithashtu, shpenzimet për programet e zhvillimit ekonomik kanë mbetur të pandryshuara gjatë periudhës së raportimit, duke evidentuar nevojën për rritje të financimit në funksion të zhvillimit ekonomik vendor.

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Trend Symbol	% Ndryshimi	Sem or
Tregues	Shpenzimet për zhvillimin ekonomik (Programi 04130) në % të buxhetit	Mije Leke	0.00	0.00	0.00	→	0.00	
Tregues	PBB lokale për frymë	Lek për frymë	662.00	662.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Përqindja e aplikimeve online për shërbime ekonomike	%	28.57	22.22	-6.35	↓	-0.22	
Tregues	Përqindja e territorit të mbuluar me PPV	%	0.08	0.08	0.00	→	0.00	
Tregues	Përqindja e territorit të mbuluar me PDV	%	0.02	0.02	0.00	→	0.00	
Tregues	Ekzistenca e PPV të miratuar	po/jo (ose 1/0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Intensiteti i zonave ekonomike në territor	%	0.04	0.04	0.00	→	0.00	
Tregues	Numri i zonave ekonomike të përcaktuara në PPV/PDV	Numër	105.00	107.00	2.00	↑	0.02	
Tregues	Lejeve te perfituara perkundrejt aplikimeve për leje zhvillimi në zonat ekonomike	Numër	52.38	60.00	7.62	↑	0.15	
Tregues	Koha mesatare e trajtimit të lejeve të zhvillimit	ditë	12.00	12.00	0.00	→	0.00	

Tregues	Numri i dokumenteve strategjike ekonomike të miratuara	Numër	4.00	4.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Numri i konsultimeve publike në fushën e ekonomisë	Numër	10.00	14.00	4.00	↑	0.40	
Tregues	Numri i raporteve të monitorimit ekonomik	Numër	7.00	7.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Pjesëmarrja e bashkisë në grupe pune / komitete sektoriale	nr. takimes h / vit	45.00	47.00	2.00	↑	0.04	

MBËSHTETJA PËR BIZNESIN

Përshkrim i përgjithshëm: Mbështetja për biznesin dhe zhvillimi ekonomik vendor janë elementë kyç për rritjen e punësimit, përmirësimin e klimës së investimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të favorshëm për bizneset, përmes ofrimit të shërbimeve mbështetëse, lehtësimit të procedurave administrative, promovimit të investimeve dhe zhvillimit të sektorëve prioritarë si agropërpunimi dhe turizmi. Gjithashtu, bashkitë kontribuojnë në informimin dhe trajnimin e bizneseve, mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), si dhe në zhvillimin e partneriteteve me sektorin privat për të nxitur rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë lokale.

Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar përpjekjet për mbështetjen e zhvillimit ekonomik vendor, nxitjen e aktivitetit sipërmarrës dhe promovimin e potencialeve ekonomike dhe turistike të territorit. Analiza e treguesve kryesorë evidenton zhvillime pozitive në drejtim të rritjes së numrit të bizneseve aktive, investimeve të reja dhe organizimit të aktiviteteve turistike dhe kulturore, megjithëse mbeten sfida në drejtim të mbështetjes direkte për ndërmarrjet dhe zhvillimit të instrumenteve të asistencës ekonomike.

Gjatë vitit raportues, numri i bizneseve aktive në territor është rritur nga 519 në 530 biznese aktive, duke reflektuar rritje të lehtë të aktivitetit ekonomik vendor. Ndërkohë, numri i bizneseve të reja të regjistruara ka pësuar rënie nga 95 në 92 biznese, ndërsa norma e krijimit të bizneseve ka zbritur nga 18.30% në 17.36%. Në të njëjtën kohë, norma e mbylljes së

bizneseve ka pësuar ulje nga 16.18% në 13.40%, duke reflektuar stabilizim relativ të aktivitetit ekonomik dhe ulje të numrit të bizneseve të mbyllura gjatë vitit 2025.

Në aspektin e përfshirjes gjinore në ekonomi, pesha e bizneseve të drejtuara nga gratë ka mbetur pothuajse në të njëjtin nivel, duke pësuar rënie të lehtë nga 19.27% në 19.06%. Po ashtu, pesha e bizneseve agro-përpunuese dhe të turizmit në strukturën e bizneseve vendore ka mbetur e qëndrueshme, me një rënie minimale nga 0.39% në 0.38%.

Një zhvillim pozitiv gjatë vitit raportues evidentohet në identifikimin e investimeve të reja në territor, ku janë regjistruar 20 investime të reja, si dhe 3 investime në zonat ekonomike. Gjithashtu, vlera e investimeve të reja të raportuara gjatë vitit 2025 ka arritur në rreth 2.51 milion euro, duke reflektuar interes në rritje për zhvillimin ekonomik dhe investimet në territorin e bashkisë.

Në fushën e turizmit dhe promovimit territorial, numri i eventeve kulturore dhe turistike është rritur nga 9 në 13 aktivitete gjatë vitit 2025, ndërsa numri i vizitorëve ditorë është rritur nga 6 në 10 vizitorë. Gjithashtu, gjatë vitit raportues është evidentuar krijimi i 1 strukture akomoduese me kapacitet prej 13 shtretërish, si dhe funksionimi i 1 qendre të informacionit turistik dhe 1 operatori turistik/guide në territor. Po ashtu, është realizuar inventarizimi i 1 atraksioni turistik në territorin e bashkisë.

Nga ana tjetër, analiza e treguesve evidenton mungesë të programeve të drejtpërdrejta mbështetëse për biznesin dhe sipërmarrjen. Gjatë vitit 2025 nuk rezultojnë të realizuara sesione informimi apo këshillimi për bizneset, nuk janë raportuar startup-e të mbështetura dhe nuk ka pasur ndërmarrje të vogla dhe të mesme të asistuara nga bashkia. Gjithashtu, nuk rezultojnë marrëveshje bashkëpunimi MoU ndërmjet bashkisë dhe organizatave të biznesit. Këta tregues evidentojnë nevojën për forcimin e politikave vendore të mbështetjes së sipërmarrjes dhe zhvillimit ekonomik lokal

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Trend Symbol	% Ndryshimi	Sem or
Tregues	Numri i bizneseve aktive	Numër	519.00	530.00	11.00	↑	0.02	
Tregues	Numri i bizneseve të reja	Numër	95.00	92.00	-3.00	↓	-0.03	
Tregues	Norma e krijimit të bizneseve	%	18.30	17.36	-0.95	↓	-0.05	

Tregues	Norma e mbylljes së bizneseve	%	16.18	13.40	-2.79	↓	-0.17	
Tregues	Pesha e bizneseve të drejtuara nga gra	%	19.27	19.06	-0.21	↓	-0.01	
Tregues	Pesha e bizneseve / agro përpunuese & turizmit	%	0.39	0.38	-0.01	↓	-0.02	
Tregues	Pesha e NVM-ve të asistuara nga bashkia	%	0.00	0.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Numri i sesioneve të informimit/këshillimit për bizneset	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Numri i pjesëmarrësve në sesione dhe trajnime ekonomike	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Numri i startup-eve të mbështetura (grant/inkubim)	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Pesha e startup-eve të mbështetura	%				↓		
Tregues	Numri i investimeve të reja në territor	Numër	0.00	20.00	20.00	↑	0.00	
Tregues	Vlera e investimeve të reja	Mijë lekë	0.00	0.00	0.00		0.00	
Tregues	Numri i investimeve në zonat ekonomike	Numër	0.00	3.00	3.00	↑	0.00	
Tregues	Numri i NVM-ve të integruara në zinxhirë vlere / konsorciume	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Numri i marrëveshjeve MoU bashki–biznes	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Numri i turistëve të huaj	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00	

Tregues	Numri i vizitorëve ditorë	Numër	6.00	10.00	4.00	↑	0.67	
Tregues	Netë-qëndrime në territor	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Numri i strukturave akomoduese	Numër	0.00	1.00	1.00	↑	0.00	
Tregues	Numri i shtretërve në struktura akomoduese	Numër	0.00	13.00	13.00	↑	0.00	
Tregues	Turistë për shtretër (raport i ngarkesës)	turistë/shtretër		0.00		↓		
Tregues	Numri i atraksioneve të inventarizuara	Numër	0.00	1.00	1.00	↑	0.00	
Tregues	Numri i operatorëve turistikë/guideve në territor	Numër	0.00	1.00	1.00	↑	0.00	
Tregues	Numri i qendrave të informacionit turistik (TIC)	Numër	0.00	1.00	1.00	↑	0.00	
Tregues	Numri i vizitorëve në qendrat TIC	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00	
Tregues	Numri i eventeve kulturore/turistike	Numër	9.00	13.00	4.00	↑	0.44	
Tregues	Numri i materialeve promocionale (broshura, fushata, web, etj.)	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00	
Nëntregues			0.00	0.00	0.00		0.00	

QEVERISJA E MIRE

Qeverisja e mirë përfaqëson aftësinë institucionale të bashkisë për të ushtruar përgjegjësitë publike me integritet, transparencë dhe efikasitet, duke garantuar përfshirjen qytetare dhe barazinë e mundësive. Në kuadër të matjes së performancës vendore, qeverisja e mirë vlerësohet përmes katër fushave përfaqësuese, të cilat reflektojnë cilësinë e proceseve të brendshme dhe kapacitetin administrativ për të siguruar rezultate të qëndrueshme:

1. Burimet Njerëzore – masin strukturën, stabilitetin dhe profesionalizmin e administratës vendore, si dhe nivelin e zhvillimit të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore.
2. Transparenca – tregon nivelin e hapjes së informacionit dhe komunikimit me qytetarët, publikimin e akteve dhe respektimin e standardeve të qeverisjes së hapur.
3. Barazia Gjinore – reflekton përpjekjet institucionale për të siguruar përfaqësim të barabartë dhe përfshirje gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe politikëbërjes lokale.
4. EU Integrimi në BE – mat aftësinë e bashkisë për të përafruar praktikat e saj me standardet evropiane, përmes projekteve bashkëpunuese, partneriteteve ndërbashkiake dhe strukturave të dedikuara të integrimit..

BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar zbatimin e politikave dhe mekanizmave institucionalë në funksion të forcimit të qeverisjes së mirë, transparencës dhe eficiencës administrative. Në fokus të veprimtarisë institucionale kanë qenë përmirësimi i shërbimeve publike, rritja e llogaridhënies, fuqizimi i pjesëmarrjes qytetare dhe modernizimi i administratës vendore.

Bashkia ka garantuar publikimin e dokumenteve kryesore financiare dhe administrative, si buxhetet, planet strategjike dhe aktet për konsultim publik, në përputhje me kuadrin ligjor për transparencën dhe të drejtën e informimit. Gjithashtu, gjatë vitit raportues janë zhvilluar konsultime publike dhe takime me komunitetin për çështje të zhvillimit vendor dhe planifikimit buxhetor, duke synuar përfshirje më të gjerë të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Në drejtim të administrimit institucional, Bashkia Maliq ka vijuar përmirësimin e proceseve administrative dhe digjitalizimin e shërbimeve publike, me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve në shërbime dhe reduktimin e procedurave burokratike. Përdorimi i platformave elektronike për aplikime, informim dhe komunikim institucional ka kontribuar në rritjen e eficiencës së administratës vendore.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve institucionale, gjatë vitit 2025 është evidentuar rritje e përqindjes së stafit të trajnuar nga 17.63% në 23.91%, si dhe rritje e numrit të punonjësve të trajnuar nga 20 në 47 punonjës. Gjithashtu, treguesi i punonjësve për 1,000 banorë është rritur nga 8.33 në 11.42 punonjës, duke reflektuar forcim të kapaciteteve administrative dhe funksionale të bashkisë.

Nga ana tjetër, gjatë vitit raportues është konstatuar rritje e shkallës së rotacionit të punonjësve të bashkisë nga 2.03% në 12.64%, si rezultat i lëvizjeve administrative dhe ndryshimeve në strukturat organizative. Ky tregues evidenton nevojën për forcim të stabilitetit institucional dhe vazhdimësi në zhvillimin e burimeve njerëzore.

Gjithashtu, bashkia ka vijuar forcimin e mekanizmave të monitorimit, auditimit dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të garantimit të përdorimit efektiv dhe transparent të fondeve publike dhe rritjes së eficiencës në zbatimin e projekteve dhe shërbimeve publike.

Në tërësi, gjatë vitit 2025 Bashkia Maliq ka vijuar konsolidimin e praktikave të qeverisjes së mirë, duke forcuar transparencën institucionale, kapacitetet administrative dhe cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve, në funksion të ndërtimit të një administrate më efikase, të përgjegjshme dhe të orientuar drejt komunitetit.

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Sem or
Tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë	%	2.03	12.64	10.60	↓	5.22 %	

Tregues	Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar	%	17.63	23.91	6.27	↑	35.57 %	
Tregues	Punonjës për 1000 banorë	punonjë s/1,000 banorë	8.33	11.42	3.09	↑	37.10 %	
Nëntregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve femra të bashkisë	%	0.72	8.91	8.20	↓	11.42 %	
Nëntregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve meshkuj të bashkisë	%	3.99	11.05	7.06	↓	1.77 %	
Nëntregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të administratës të bashkisë	%	2.02	10.13	8.12	↓	4.02 %	
Nëntregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të njësive shpenzuese të bashkisë	%	4.60	13.56	8.96	↓	1.95 %	
Nëntregues	Përqindja e stafit femra të trajnuar	%	22.49	3.88	-18.61	↓	-82.76 %	
Nëntregues	Përqindja e stafit meshkuj të trajnuar	%	9.96	10.76	0.79	↑	7.95 %	
Nëntregues	Përqindja e stafit të administratës të trajnuar	%	17.51	7.81	-9.70	↓	-55.41 %	
Nëntregues	Përqindja e stafit të njësive shpenzuese të trajnuar	%	8.97	2.03	-6.93	↓	-77.31 %	

B) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

Kodi I të dhënës	E dhëna	Viti 2024	Viti 2025	Njësia Matëse
D73	Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit	608	602	Numër
D74	Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit	44	61	Numër
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	61705	61607	Numër
D75	Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit	20	47	Numër
D76	Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit	5	3	Numër

TRANSPARENCA

Të dhëna të Përgjithshme:Transparenca në pushtetin vendor është parimi që siguron që qytetarët të kenë qasje të lirë dhe të kuptueshme në informacionin publik, dokumentet zyrtare, si dhe proceset vendimmarrëse të njësisë vendore. Ajo nënkupton publikimin e vendimeve, buxhetit, planeve dhe raporteve të ndryshme, duke mundësuar që qytetarët të jenë të informuar, të përfshihen në konsultime publike dhe të kërkojnë llogari nga institucionet lokale për veprimet apo mosveprimet e tyre.

Transparenca forcon besimin mes qytetarëve dhe qeverisjes vendore, dhe ndihmon në parandalimin e abuzimeve apo korrupsionit.Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar zbatimin e masave institucionale në funksion të forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së hapur, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për konsultimin publik dhe të drejtën e informimit. Veprimtaria institucionale është orientuar drejt garantimit të aksesit të publikut në informacion, përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe konsolidimit të standardeve të integritetit administrativ.

Analiza e treguesve të transparencës evidencon se gjatë periudhës së raportimit është ruajtur niveli 100% i realizimit të konsultimit publik për të gjitha aktet për të cilat ky proces është i detyrueshëm me ligj. Konkretisht, gjatë vitit 2025 janë evidentuar 9 akte që i janë nënshtruar procedurës së konsultimit publik, kundrejt 6 akteve në vitin 2024, duke reflektuar rritje të angazhimit institucional në funksion të përfshirjes së publikut dhe grupeve të interesit në proceset e hartimit dhe miratimit të akteve vendore.



A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Sem or
Tregues	Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00 %	
Tregues	Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00 %	

Tregues	Plani Vendor i Integritetit	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00 %	
Nëntregues			0.00	0.00	0.00		0.00 %	

Sfida	Arritje	Objektiva
• Nevoja për zgjerimin e përdorimit të kanaleve digjitale për informim dhe komunikim me qytetarët. • Rritja e ndërveprimit publik dhe pjesëmarrjes aktive në proceset konsultuese. • Ruajtja e standardeve të transparencës dhe monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të tyre.	• U ruajt publikimi i raportit vjetor të transparencës në mënyrë të vazhdueshme. • U konsolidua zbatimi i Planit Vendor të Integritetit si instrument i rëndësishëm institucional.	• Zhvillimi i mëtejshëm i platformave online për transparencë dhe akses publik në informacion. • Rritja e pjesëmarrjes qytetare në konsultimet publike dhe proceset vendimmarrëse. • Forcimi i mekanizmave të integritetit dhe llogaridhënies institucionale.

Gjithashtu, Bashkia Maliq ka vijuar publikimin e raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes, si dhe zbatimin e Planit Vendor të Integritetit, të cilët kanë mbetur në fuqi dhe funksionalë gjatë gjithë vitit raportues. Këta tregues dëshmojnë vazhdimësinë e mekanizmave institucionalë për garantimin e transparencës, etikës administrative dhe parandalimit të konflikteve të interesit në ushtrimin e funksioneve publike. Në funksion të përmirësimit të komunikimit institucional dhe aksesit të qytetarëve në informacionin publik, bashkia ka vijuar publikimin periodik të dokumenteve strategjike, akteve administrative dhe informacionit financiar në faqen zyrtare të institucionit, duke garantuar respektimin e standardeve të transparencës dhe informimit publik.Në tërësi, gjatë vitit 2025 Bashkia Maliq ka ruajtur standarde të qëndrueshme në fushën e transparencës dhe qeverisjes së hapur, duke forcuar mekanizmat e konsultimit publik, llogaridhënies institucionale dhe integritetit administrativ, në funksion të rritjes së besimit të qytetarëve ndaj institucionit vendor.

BARAZIA GJINORE

Përshkrim i përgjithshëm: Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar angazhimin institucional në funksion të promovimit të barazisë gjinore dhe rritjes së përfaqësimit të grave në strukturat vendimmarrëse dhe administrative të bashkisë. Politikat dhe masat e ndërmarra gjatë periudhës së raportimit janë orientuar drejt forcimit të përfshirjes së grave në jetën publike dhe garantimit të mundësive të barabarta në administratën vendore.

Analiza e treguesve kryesorë evidenton një përmirësim të ndjeshëm në përfaqësimin e grave në pozicione drejtuese politike dhe administrative të bashkisë. Përqindja e grave në pozicione si kryetare, nënkryetare, administratore dhe anëtare të këshillit bashkiak është rritur nga 20.00% në 37.50%, duke reflektuar një rritje prej 87.50% krahasuar me vitin paraardhës. Ky zhvillim lidhet me rritjen e numrit të grave në këto pozicione nga 2 në 15, ndërkohë që numri total i pozicioneve drejtuese të këtij niveli ka arritur në 40 pozicione gjatë vitit 2025.

Nga ana tjetër, vihet re rënie e përqindjes së grave në pozicione drejtuese të niveleve të ndryshme administrative (të larta, të mesme dhe të ulëta), e cila ka zbritur nga 48.48% në 40.43%. Megjithëse numri i grave në këto pozicione është rritur nga 16 në 19, zgjerimi i numrit total të pozicioneve drejtuese nga 33 në 47 ka ndikuar në uljen e përfaqësimit në përqindje. Ky tregues evidenton nevojën për forcimin e politikave të qëndrueshme për promovimin dhe ruajtjen e përfaqësimit gjinor në të gjitha nivelet e administratës.

Një zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit raportues ka qenë miratimi dhe zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, i cili më parë nuk rezultonte i miratuar. Ky plan përbën një instrument të rëndësishëm institucional për orientimin e politikave vendore në funksion të barazisë gjinore, fuqizimit të grave dhe garantimit të përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse dhe zhvillimore.

A) Treguesit përmbledhë

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Sen or
Tregues	Përqindja e grave në pozicione: kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore	%	20.00	37.50	17.50	↑	87.50 %	
Tregues	Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki	%	48.48	40.43	-8.06	↓	-16.62 %	
Tregues	Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore	Cilësore (Po/Jo)	0.00	1.00	1.00	↑	0.00 %	

Në tërësi, gjatë vitit 2025 Bashkia Maliq ka shënuar progres në drejtim të rritjes së përfaqësimit të grave në strukturat drejtuese dhe forcimit të kuadrit institucional për barazinë gjinore. Megjithatë, mbetet e nevojshme vijimi i politikave mbështetëse dhe forcimi i mekanizmave institucionalë për garantimin e një përfaqësimi të balancuar gjinor në të gjitha nivelet e administratës vendore.

EU INTEGRIMI NË BE

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, përfshirë pushtetin vendor. Bashkitë luajnë një rol kritik në afërsimin me acquis communautaire dhe përmbushjen e kritereve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve.

Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar angazhimin institucional në funksion të procesit të integrimit evropian, nëpërmjet forcimit të strukturave administrative, pjesëmarrjes në aplikime për fonde të Bashkimit Evropian dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Procesi i integrimit

evropian ka mbetur një ndër prioritetet kryesore të zhvillimit vendor, duke synuar përmirësimin e kapaciteteve administrative dhe përafrimin me standardet evropiane të qeverisjes vendore.

Analiza e Fushes

Analiza e treguesve kryesorë evidenton se gjatë vitit raportues kanë vijuar të funksionojnë strukturat e performancës,Gjithashtu, komisionet e integrimit evropian pranë Këshillit Bashkiak kanë mbetur funksionale gjatë gjithë periudhës së raportimit, duke garantuar vazhdimësinë institucionale të procesit të koordinimit dhe monitorimit të politikave të integrimit.

Në aspektin e përfitimit të fondeve të Bashkimit Evropian, gjatë periudhës raportuese Bashkia Maliq ka aplikuar në 9 projekte të financuara nga BE, kundrejt 10 aplikimeve të realizuara gjatë vitit paraardhës. Nga këto aplikime, janë fituar 2 projekte, krahasuar me 3 projekte të fituara gjatë vitit 2024. Për pasojë, treguesi i projekteve të fituara kundrejt atyre të aplikuara ka pësuar rënie nga 30.00% në 22.22%, duke reflektuar vështirësitë dhe konkurrencën e lartë në përthithjen e fondeve evropiane.

Po ashtu, numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara ka pësuar rënie nga 4 marrëveshje në vitin 2024 në 2 marrëveshje gjatë vitit 2025. Ky tregues evidenton nevojën për forcimin e bashkëpunimit ndërvendor dhe zgjerimin e partneriteteve institucionale në funksion të zhvillimit rajonal dhe përfitimit nga programet ndërkufitare dhe fondet evropiane.

Një ndër sfidat kryesore të pushtetit vendor në kuadër të integrimit evropian mbetet mungesa e Planit Vendor të Migracionit dhe Diasporës, i cili vijon të mos jetë i miratuar apo i zbatuar gjatë periudhës së raportimit. Ky element konsiderohet i rëndësishëm në kuadër të politikave të integrimit, menaxhimit të migracionit dhe përfshirjes së diasporës në zhvillimin vendor.

Në tërësi, procesi i integrimit evropian në Bashkinë Maliq karakterizohet nga ruajtja e strukturave institucionale dhe vijimësia e angazhimit në aplikime për fonde të Bashkimit Evropian, megjithatë evidentohen sfida të lidhura me kapacitetet për përthithjen e fondeve, zgjerimin e bashkëpunimit ndërbashkiak dhe hartimin e politikave vendore në funksion të integrimit evropian.

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Sem or

Tregues	Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki	Numër	4.00	2.00	-2.00	↓	-50.00 %	
Tregues	Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00 %	
Tregues	Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga bashkimi evropian (periudha 2-vjeçare 2023-2024)	%	30.00	22.22	-7.78	↓	-25.93 %	
Tregues	Planet e migracionit dhe diasporës	Cilësore (Po=1/Jo=0)	0.00	0.00	0.00	→	0.00 %	
Tregues	Komisionet e integrimit evropian pranë këshillave bashkiakë	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00 %	
Nëntregues			0.00	0.00	0.00		0.00 %	

B) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Viti 2024	Viti 2025	Njësia Matëse
Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara	4	2	Numër
Struktura e performancës e përfshirë në organizimin funksional të bashkisë	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
Strukturat e performancës ngritur pranë drejtorisë së Integrimit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së	0	0	Cilësore (Po=1/Jo=0)

Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës se raportimit	10	9	Numër
Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës se raportimit	3	2	Numër
Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0	0	Cilësore (Po=1/Jo=0)
Komisionet e Integrimit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)

Përfundim

Gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar angazhimin institucional në procesin e integrimit evropian, duke ruajtur funksionalitetin e strukturave përgjegjëse dhe pjesëmarrjen në aplikime për fonde të Bashkimit Evropian. Megjithatë, përshpejtimi i procesit të integrimit dhe rritja e përfitimit nga instrumentet financiare të BE-së kërkon forcim të mëtejshëm të kapaciteteve administrative, zgjerim të bashkëpunimit ndërvendor dhe hartim të politikave vendore të orientuara drejt standardeve evropiane.

MENAXHIMI FINANCIAR

Analiza e treguesve financiarë evidenton një situatë të qëndrueshme në drejtim të administrimit financiar dhe realizimit të buxhetit, duke reflektuar përmirësime në disa prej treguesve kryesorë të performancës fiskale, por edhe sfida që kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme në rritjen e autonomisë financiare dhe optimizimin e strukturës së shpenzimeve.

Gjatë vitit aktual, "Të ardhurat e veta për frymë" kanë shënuar rritje nga 2,770.29 lekë/person në 3,022.89 lekë/person, me një rritje prej 9.12%, çka tregon përmirësim të kapaciteteve të mbledhjes së të ardhurave vendore dhe zgjerim të bazës fiskale.

Gjithashtu, raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit është rritur me 7.23%, duke reflektuar një kontribut më të madh të burimeve vendore në financimin e aktiviteteve të bashkisë.

Pozitiv paraqitet edhe treguesi i "Shkallës së ekzekutimit të buxhetit", i cili është rritur në 96.01%, duke treguar eficiencë më të lartë në realizimin e planifikimit financiar dhe përdorimin e fondeve publike sipas programeve të miratuara. Po ashtu, pesha e investimeve në buxhet ka pësuar një rritje të lehtë, duke arritur në 23.53%, çka dëshmon

vazhdimësinë e orientimit të fondeve drejt investimeve publike dhe përmirësimit të infrastrukturës vendore.
Megjithatë, disa tregues evidentojnë nevojën për masa përmirësuese. Raporti i të ardhurave të veta kundrejt transfertave ka pësuar rënie me 13.14%, duke treguar një varësi më të lartë nga transfertat qendrore dhe një autonomi fiskale ende të kufizuar. Në të njëjtën linjë, të ardhurat nga taksa e pasurisë në raport me të ardhurat vendore kanë rënë me 19.32%, duke reflektuar nevojën për forcimin e administrimit fiskal, përditësimin e regjistrave dhe rritjen e eficiencës në arkëtimin e kësaj takse.
Rënie është konstatuar edhe në treguesin e investimeve për frymë, i cili ka zbritur me 6.88%, si rezultat i kufizimeve financiare dhe riorientimit të fondeve drejt shpenzimeve operacionale dhe nevojave funksionale të institucionit. Ndërkohë, pesha e personelit dhe shpenzimeve operacionale në buxhet ka shënuar rritje, duke reflektuar zgjerimin e kostove administrative dhe nevojën për menaxhim më eficient të shpenzimeve korrente.
Një element që kërkon vëmendje të veçantë është rritja e peshës së detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve, e cila ka kaluar nga 0.39% në 5.83%, tregues që nënvizon nevojën për forcimin e kontrollit financiar dhe menaxhimit të likuiditetit.
Në tërësi, treguesit financiarë dëshmojnë se bashkia ka ruajtur stabilitetin në menaxhimin e financave publike dhe ka përmirësuar realizimin buxhetor, ndërsa prioritet për periudhën në vijim mbetet rritja e të ardhurave të veta, ulja e varësisë nga transfertat, përmirësimi i eficiencës së shpenzimeve dhe forcimi i qëndrueshmërisë financiare afatgjatë.

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semor
Tregues	Të ardhurat e veta për frymë	leke/person	2770.29	3022.89	252.59	↑	9.12%	
Tregues	Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave	%	16.49	14.32	-2.17	↓	-13.14%	
Tregues	Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit	%	10.17	10.90	0.74	↑	7.23%	

Tregues	Shkalla e përdorimit të të ardhurave	%	85.41	75.43	-9.98	↓	-11.68 %	
Tregues	Të ardhurat nga taksa e pasurisë ne raport me të ardhurat vendore	%	26.03	21.00	-5.03	↓	-19.32 %	
Tregues	Buxheti i miratuar për frymë	leke/person	24818.52	21779.57	-3038.95	↓	-12.24 %	
Tregues	Shkalla e ekzekutimit të buxhetit	%	93.75	96.01	2.26	↑	2.41%	
Tregues	Investime për frymë	leke/person	5284.42	4920.95	-363.47	↓	-6.88%	
Tregues	Pesha e investimeve në buxhet	%	22.71	23.53	0.82	↑	3.61%	
Tregues	Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve	%	0.39	5.83	5.44	↓	13.77 %	
Tregues	Pesha e personelit në buxhet	%	31.52	41.85	10.34	↑	32.79 %	
Tregues	Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet	%	45.77	50.34	4.57	↑	9.99%	
Nëntregues			0.00	0.00	0.00		0.00%	

C) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Të ardhurat e veta, fakt	170941	186231	Mijë Leke

Popullsia e përgjithshme e bashkisë	61705	61607	Numër
Transfertat gjithsej, fakt	1036669	1300267	Mijë Leke
Të ardhurat e përgjithshme, fakt	1680945	1707816	Mijë Leke
Totalit i shpenzimeve të bashkisë , fakt	1435690	1490866	Mijë Leke
Të ardhurat nga taksa e pasurisë, fakt	44489	39104	Mijë Leke
Shpenzime gjithsej, plan i rishikuar	1531427	1707816	Mijë Leke
Shpenzime kapitale, fakt	326075	303165	Mijë Leke
Detyrime të papaguara mbi 30 ditë	5670	75165	Mijë Leke
Shpenzime personeli, fakt	452506	539188	Mijë Leke
Shpenzime operacionale, fakt	657109	648513	Mijë Leke

Fusha	**Arritjet Kryesore**	**Sfidat Kryesore**	**Objektivat**
Të ardhurat vendore	Rritje e të ardhurave të veta për frymë me 9.12%	Varësi e lartë nga transfertat qendrore	Rritja e autonomisë financiare dhe zgjerimi i bazës tatimore
Menaxhimi fiskal	Përmirësim i raportit të të ardhurave të veta ndaj buxhetit	Ulje e të ardhurave nga taksa e pasurisë	Përmirësimi i administrimit të taksave dhe arkëtimeve

Fusha	Arritjet Kryesore	Sfidat Kryesore	Objektivat
Ekzekutimi buxhetor	Shkalla e ekzekutimit të buxhetit arriti 96.01%	Nevoja për planifikim më të qëndrueshëm të investimeve	Rritja e eficiencës në realizimin e programeve buxhetore
Investimet publike	Rritje e peshës së investimeve në buxhet	Ulje e investimeve për frymë	Orientimi i fondeve drejt projekteve prioritare dhe infrastrukturore
Menaxhimi i shpenzimeve	Ruajtje e funksionimit të shërbimeve publike	Rritje e shpenzimeve operacionale dhe të personelit	Optimizimi i strukturës së shpenzimeve dhe eficienca administrative
Menaxhimi financiar	Përmirësim i monitorimit financiar	Rritje e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve	Forcimi i kontrollit financiar dhe ulja e detyrimeve të prapambetura
Qëndrueshmëria financiare	Stabilitet në administrimin e financave vendore	Kufizime në burimet financiare vendore	Rritja e kapaciteteve financiare dhe sigurimi i qëndrueshmërisë afatgjatë

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfidat Kryesore	Arritjet Kryesore	Objektivat për Vitin 2026
Arsimi Parauniversitar	Infrastrukturë arsimore që kërkon rehabilitim dhe përmirësim të kushteve në disa institucione arsimore, veçanërisht në zonat rurale.	Vazhdimësia e funksionimit të shkollave dhe kopshteve, si dhe mirëmbajtja e objekteve arsimore.	Rikonstruksioni i objekteve arsimore
Menaxhimi i Mbetjeve	Mungesa e progresit në reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane.	Mbulim i plotë i territorit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe rritje e mbulimit të kostove nga tarifat.	Rritja e riciklimit dhe përmirësimi i menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve.
Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi	Nevoja për modernizimin e pajisjeve zjarrfikëse dhe forcimin e kapaciteteve operacionale.	Garantimi i reagimit ndaj emergjencave dhe funksionimi i shërbimit zjarrfikës në territor.	Përmirësimi i flotës zjarrfikëse dhe rritja e kapaciteteve të mbrojtjes civile.
Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	Amortizimi i rrjetit ujitës dhe nevoja për rehabilitimin e skemave ujore rajonale.	Ruajtja e funksionalitetit të sistemit kullues dhe ujitës në territor.	Rehabilitimi i skemave ujore dhe zgjerimi i sipërfaqeve të mbuluara me ujitje.
Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	Nevoja për rehabilitim të sipërfaqeve të degraduara dhe mbrojtje më të madhe të fondit pyjor.	Ruajtja e mbulimit me plane mbarështimi dhe rritja e kapaciteteve monitoruese.	Investime në pyllëzim dhe forcim i masave mbrojtëse ndaj dëmtimeve dhe zjarreve.

Fusha	Sfidat Kryesore	Arritjet Kryesore	Objektivat për Vitin 2026
Mbrojtja Sociale	Kapacitete të kufizuara për strehimin social dhe zgjerimin e shërbimeve komunitare.	Rritja e mbështetjes për familjet në nevojë dhe grupet vulnerabël.	Zgjerimi i qendrave sociale dhe forcimi i mbështetjes sociale komunitare.
Rrjeti Rrugor	Mungesa e sinjalistikës rrugore dhe amortizimi i akseve rurale.	Shtrimi i segmenteve rrugore dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues rrugor.	Rehabilitimi i akseve rurale dhe përmirësimi i sigurisë rrugore.
Transporti Publik	Reduktimi i numrit të automjeteve dhe mungesa e monitorimit të treguesve të përdorimit të shërbimit.	Rritja e numrit të linjave të transportit publik.	Modernizimi i flotës dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në transport publik.
Ndriçimi Publik	Problematika në mirëmbajtjen e ndriçimit rural dhe rënia e të ardhurave nga tarifat.	Rritja e rrjetit dhe pikave funksionale të ndriçimit publik.	Zgjerimi i ndriçimit publik dhe investime në sisteme eficente energjetike.
Gjelbërimi i Sipërfaqeve Publike	Mirëmbajtja e pamjaftueshme e hapësirave të gjelbra dhe mungesa e gjelbërimit rural.	Rritja e sipërfaqeve të gjelbra dhe shtimi i numrit të pemëve të mbjella.	Zgjerimi i hapësirave të gjelbra dhe përmirësimi i mirëmbajtjes mjedisore.
Mirëmbajtja e Varrezave	Ulja graduale e kapaciteteve të lira dhe rënia e të ardhurave nga tarifat.	Ruajtja e mirëmbajtjes së varrezave sipas planit.	Planifikimi i zgjerimit të kapaciteteve dhe përmirësimi i administrimit të shërbimit.
Kultura	Nevoja për rehabilitimin e objekteve kulturore dhe zgjerimin e aktiviteteve në zonat rurale.	Rritja e aktiviteteve kulturore dhe pjesëmarrjes së komunitetit.	Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe modernizimi i infrastrukturës kulturore.
Sport & Argëtim	Mungesa e aktiviteteve sportive dhe rënia e pjesëmarrjes së komunitetit.	Përmirësimi i objekteve sportive dhe rritja e investimeve në sport.	Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rehabilitimi i infrastrukturës sportive.

Fusha	Sfidat Kryesore	Arritjet Kryesore	Objektivat për Vitin 2026
📍 Planifikimi Strategjik	Nevoja për rritje të investimeve dhe përmirësim të shërbimeve online.	Rritja e konsultimeve publike dhe zhvillimi i zonave ekonomike.	Përmirësimi i planifikimit territorial dhe zhvillimit ekonomik vendor.
💼 Mbështetja për Biznesin dhe Zhvillimi Ekonomik	Mungesa e programeve mbështetëse për sipërmarrjen dhe biznesin lokal.	Rritja e investimeve të reja dhe promovimi i aktiviteteve turistike.	Mbështetja e sipërmarrjes lokale dhe zhvillimi i turizmit vendor.
👥 Burimet Njerëzore	Nevoja për stabilitet institucional dhe forcim të kapaciteteve administrative.	Rritja e numrit të stafit të trajnuar dhe përmirësimi i kapaciteteve administrative.	Zhvillimi profesional i stafit dhe forcimi i administratës vendore.
📖 Transparenca dhe Qeverisja e Hapur	Nevoja për zgjerimin e mekanizmave të transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare.	Rritja e konsultimeve publike dhe publikimit të informacionit institucional.	Digjitalizimi i mëtejshëm i shërbimeve dhe forcimi i llogaridhënies publike.
⚖️ Barazia Gjinore	Nevoja për rritjen e përfaqësimit gjinor në nivelet administrative dhe vendimmarrëse.	Rritja e pjesëmarrjes së grave në pozicione drejtuese.	Zbatimi i politikave për fuqizimin ekonomik dhe social të grave.
EU Integrimi Evropian	Kapacitete të kufizuara për përthithjen e fondeve dhe zhvillimin e partneriteteve ndërkombëtare.	Vazhdimësia e aplikimeve në projekte të Bashkimit Evropian.	Rritja e përfitimit nga fondet e BE-së dhe forcimi i bashkëpunimit ndërvendor.
💰 Performanca Financiare	Rritja e detyrimeve financiare dhe ulja e investimeve publike.	Rritja e të ardhurave vendore dhe zgjerimi i kapaciteteve buxhetore.	Forcimi i disiplinës fiskale dhe rritja e investimeve zhvillimore.

Në tërësi, analiza e treguesve të performancës për vitin 2025 evidenton se Bashkia Maliq ka ruajtur një performancë institucionale të qëndrueshme dhe në përmirësim në shumicën e fushave të shërbimeve publike vendore, zhvillimit ekonomik dhe qeverisjes së mirë. Përmirësimet në infrastrukturë, transparencë, mbrojtje sociale, gjelbërim publik dhe menaxhim institucional dëshmojnë angazhimin e bashkisë për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët.

Megjithatë, analiza evidenton edhe sfida që lidhen me nevojën për rritje të investimeve, forcimin e kapaciteteve administrative dhe financiare, modernizimin e infrastrukturës publike dhe përmirësimin e eficiencës në disa sektorë specifikë. Në këtë kuadër, Bashkia Maliq mbetet e angazhuar për vijimin e reformave dhe zbatimin e politikave zhvillimore në funksion të një administrate më efikase, transparente dhe të orientuar drejt nevojave të komunitetit.